



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER MAJLINDA DEMOLLARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA
NR .10
TEL: 0682061560**

KONTRATE POROSIE

Nr. repertori: 1982

Nr. koleksioni: 812

Tirane më 10/04/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"


***Akti noterial përbëhet nga 4 fletë**



A2020053790023417405

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR 1982 REP.
NR 012 KOL.



**PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES PËR SHITBLERJE AKSIONESH
ME REP. 490 DHE KOL. 160, DT. 21.01.2020**

Sot më datë 10.04.2020, përpara meje noteres Majlinda E. Demollari, me zyre noterie në Rruga "Vaso Pasha", Nr. 8, Tiranë u paraqitën personalisht palët kontraktuese:

➤ **BLERËSI:**

Shoqëria "Hysenbelliu" shpk, person juridik shqiptar, rregjistruar ne Regjistrin Tregtar me nr NIPT J81813004C, me seli në adresën: rruga "Panorama", pranë Hotel "Prestige", përfaqësuar nga Administratori, Znj. Arta Sino, e bija e Besnik, lindur më 22.03.1987, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga "Myslym Shyri", Pallati 5, Shkalla 3, Apartamenti 17, mbajtëse e Letërnjoftimit me nr. personal I75322010K, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

➤ **SHITËSI:**

Z. Adrian Doçi, shtetas shqiptar, i biri i Skënderit, lindur më 20.06.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën, Rr. "Shemsi Haka" Nr. 23, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. Personal 029809071, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

REFERUAR BASHKARISHT SI "PALËT"

Ekzistojnë këto kushte paraprake:

- (A) Shitësi është aksionar i shoqërisë "Birra Tirana" sha, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik biznesi (NIPT) J61821051F, me adresë: Rruga "Kavajës", Tiranë, Shqipëri.

Blerësi dhe Shitësi kanë lidhur një Marrëveshje për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari (në vijim referuar edhe si "Marrëveshja"), sipas së cilës:

- Shitësi do t'i shesë Blerësit 108,168 aksione, të cilat përfaqësojnë 9.74% të kapitalit të shoqërisë "Birra Tirana" sh.a kundrejt pagesës prej EURO 1,146,000 (një milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë);

- (C) Në neni 3.1 i Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, është përcaktuar se Blerësi do të realizojë pagesën jo më vonë se data 31 Mars 2020;
- (D) Gjatë muajit Mars 2020, në Republikën e Shqipërisë është përhapur virusi Sars-Cov-2 (COVID-19), i cili ka passjellë në mbylljen e aktiviteteve në të gjithë Republikën e Shqipërisë, shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe si Forcë Madhore ka ndikuar dhe në përmbushjen e Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari.

Sa më sipër, palët, pasi kanë biseduar, kanë rënë dakord të zgjatin afatin e Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, si dhe të kryejnë ndryshimet si vijon:

NENI 1

Palët, pasi diskutuan paraprakisht në lidhje me ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, lidhur ndërmjet tyre, bien dakord që pika 3.1.1 (Çmimi I Blerjes) e Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, të ndryshojë si më poshtë vijon:

"3.1.1 Pagesa totale per Aksionet e "Birra Tirana" sha në masën 108,168 aksione, të cilat përfaqësojnë 9.74% të kapitalit do të jetë e barasvlershme me EURO 1,146,000 (një milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë Euro) dhe do të paguhet pas disbursimit të kredisë nga "Banka e Tiranës" sha, në llogari të Blerësit, në çdo rast jo më vonë se data 30 Prill 2020."

NENI 2



Pikat 3.2.1 dhe 3.2.3 të Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, ndryshohen si më poshtë:

"3.2.1 Blerësi me qëllim pagimin e çmimit të blerjes prej EURO 1,146,000 (një milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë Euro) ka aplikuar pranë "Banka e Tiranës" sh.a për të marrë financim/kredi."


"3.2.3 Nëse do të jetë e nevojshme dhe e kërkueshme nga "Banka e Tiranës" sh.a, me nënshkrimin e Kontratës për Shitblerjes e Aksioneve, Shitesi pranon të vendosë një barrë siguruese dhe/ose peng mbi Aksionet në shitje, objekt kontrate, në favor të bankës, me qëllim disbursimin e kredisë që do t'i jepet Blerësit nga banka për pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve sipas kësaj Marrëveshje."

NENI 3

Pika 3.2.5 e Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, ndryshohet si më poshtë:

"3.2.5 Me pagimin e plotë të vlerës së çmimit nga  i në llogarinë e , "Banka e Tiranës" sh.a do të lëshojë menjëherë një deklaratë noteriale, do të përpilojë dhe nënshkruajë formularin përkatës pranë Regjistrat të Barrave Siguruese dhe/ose çdo akt tjetër sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse, me anë të së cilës jep miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve, objekt kontrate, nga Shitesi tek Blerësi dhe regjistrimit të tyre në emër të Blerësit pranë regjistrave përkatës në autoritetet shtetërore sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje".

NENI 4

Paragrafi i tretë i pikës 7.2.3 të Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep. Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, ndryshohet si më poshtë: 

"- Aksionet e "Birra Tirana" nëse janë të barrësuara, të vendosura peng apo mbi to ka ndonjë opsion ose e drejtë tjetërsimi ose barrësimi, nga ana e Shitesit do të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme për lirimin e tyre tërësisht përpara disbursimit të kredisë nga Banka dhe kalimit të çmimit të aksioneve nga Shitesi tek Blerësi. Përjashtohet nga ky parashikim barrësimi dhe/ose vendosja peng i aksioneve të Shitesit për garantimin e financimit/kredisë që do të përfitojë Blerësi nga "Banka e Tiranës" sh.a, sipas parashikimit të pikave 3.1.1, 3.2.1, 3.2.2 dhe 3.2.3 të kësaj Marrëveshje".



NENI 5

Me përjashtim të ndryshimeve më sipër, Marrëveshja për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari nuk ka asnjë ndryshim tjetër dhe palët njohin të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta që burojnë prej saj.

NENI 6

Ky ndryshim Marrëveshje hartohet në 5 (pesë) ekzemplarë dhe i bashkëngjitet Marrëveshjes për Shitblerje Aksionesh Nr. 490 Rep., Nr. 160 Kol., datë 21.01.2020, Noter Majlinda E. Demollari, dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

Sa më sipër unë Noterja e lexoj më zë të lartë në prani të palëve, të cilët më deklaruan se kuptojnë plotësisht përmbajtjen e këtij aneksi kontrate dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruajnë atë.

BLERËSI

SHOQËRIA "HYSENBELLIU" SHPK

Përfaqësuar nga

Z. Arta SINO



SHITËSI

Adrian DOÇI



NOTER

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: K4160540A
Tel: 0678011560